



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja **a**, dhe të nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Hazir (Jahir) Tahiri dhe Qamile (Hazir) Vrapçani.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 741-18, Zona kadastrale Matiçan, certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00741-18, e evidentuar si pasuri shoqërore “rrugë publike e pakategorizuar, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr. 741-8, ZK Matiçan, certifikata e pronësisë nr. P 71914050-00741-8 dhe pjesën e parcelës nr. 741-9 , ZK Matiçan, certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00741-9, e destinuar për interes të përgjithshëm “rrugë”, e planifikuar sipas Planit rregullues ”Mati 1” dhe PZHU-së, në pronësi të Hazir (Jahir) Tahirit dhe Qamile (Hazir) Vrapçanit.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “ Mati 1 “ dhe PZHU-së. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme komunale dhe vlerësimi i pronës private.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës që do të shkëmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0263686/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

